



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1148/1 prot.

Tiranë më 9.10.2020

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

Z. ERION BRAÇE

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

KRYEMINISTRIA

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 4873/1 prot., datë 24.09.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin "*Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Portali Unik Qeveritar e-Albania" dhe për miratimin e rregullave "Mbi mënyrën e funksionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit"*, së bashku me relacionin shpjegues dhe tabelat e përputhshmërisë në shqip dhe anglisht, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Zyra e Komisionerit*").

Nga shqyrtimi i relacionit dhe tabelës së përputhshmërisë, konstatohet se krijimi i bazës shtetërore të të dhënave "*Portali Unik Qeveritar e-Albania*", bazohet në ligjin nr. 10 325, datë 23.09.2010 "*Për bazat e të dhënave shtetërore*" dhe ligjin nr. 66/2016 "*Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë*".

Gjithashtu, krijimi i kësaj baze të dhënash shtetërore synon edhe përafrimin e legjislacionit vendas me Rregulloren (BE) 2018/1724 "*Mbi një portë të vetme digjitale për ofrimin e aksesit në informacion, procedura, asistencë dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave dhe që ndryshon Rregulloren (BE) 2012/1024*".

Nga përmbajtja e nenit 4 dhe 5 të projektvendimit, vërejmë se të dhënat ndahen në dy kategori, në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore.

Duke iu referuar kësaj ndarjeje, bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji 9887/2008*"), rezulton se

administratori i Portali Unik Qeveritar e-Albama bart, njeneresh, cilesi dhe role të ndryshme në procesin përpunues të të dhënave personale.

Kështu, sa i takon të dhënave parësore (si p.sh. “Kodi unik i përdoruesit), bazuar në pikën 5 të nenit 3 të Ligjit 9887/2008, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) rezulton të jetë në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave.

Sa i përket të dhënave dytësore, AKSHI në këtë rast, parimisht, rezulton të jetë në cilësinë e përpunuesit të të dhënave (referuar pikës 7 të nenit 3 të Ligjit 9887/2008), por nga ana tjetër edhe në cilësinë e bashkëkontrolluesit të të dhënave (së bashku me autoritetet përkatëse përgjegjëse), në lidhje me detyrimin për marrjen e masave për ruajtjen dhe garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit, si dhe për t’ju mundësuar subjekteve të të dhënave personale ushtrimin e të drejtave të tyre.

Për këtë arsye, edhe për këto të dhëna (krahas atyre parësore) AKSHI ka detyrimin të marrë masa tekniko-organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe ruajtjes së konfidencialitetit, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të Ligjit 9887/2008, njësoj sikur të ishte kontrolluesi i vetëm i tyre.

Në këtë kontekst, detyrimet që burojnë nga dispozitat e mësipërme ligjore, zërthehen, më konkretisht, në aktet nënligjore të Komisionerit të nxjerra në zbatim të dispozitave në fjalë, ku veçojmë, ndër të tjera, parashikimet detyruese të udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”.

Në konkluzion të sa parashtrohet më sipër, sugjerojmë që përmbajtja e nenit 24 të projektvendimit të ndryshojë si vijon:

“Neni 24

Mbrojtja e të dhënave personale

Portali Unik Qeveritar e- Albania administrohet dhe mirëmbahet, në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin dhe menaxhimin e sigurisë së informacionit, përpunimin e të dhënave personale, si dhe informimin e subjektit të të dhënave personale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

